

08/09/2024

Grupi Lokal i Veprimit
Local Action Group

NATYRA

REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

MARRE NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED

Nësisia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numrit Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	56253	2



KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L040, dispozitave të statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë me datë 08.09.2021, lidhë këtë :

Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të
GRUPI LOKAL TË VEPRIMIT "NATYRA"
dhe
Komunës së Suharekës

Neni 1 Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Grupit Lokal të Veprimit (GLV) „Natyra”, të përfaqësuar nga **Ejup Ismajli – Kryetar i GLV „Natyra”** dhe të Komunës së Suharekës të përfaqësuar nga **Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës**, me qëllim të financimit të projektit “Pastrimi dhe restaurimi i vegetacionit në shtratin e ristrukturuar natyror të lumit Toplluha, seksioni Leshan-Tërrnje”, të mbështetur nga programi i Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH mbi "Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike përmes Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet në Ballkanin Perëndimor" sipas kontratës me nr.8338612 dt. 23.03.2021 në mes të GIZ dhe GLV “Natyra”.

Neni 2 Kushtet për formimin e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh pastrimin dhe restaurimin e vegetacionit në shtratin e ristrukturuar natyror të lumit Toplluha, seksioni Leshan-Tërrnje, sipas projekt propozimit të Komunës së Suharekës të miratuar nga programi GIZ, për seksionin Leshan-Tërrnje.

Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për zbatimin e projektit pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit sesioni Leshan – Tërrnje, mbrojtja nga vërshimet dhe krijimin e kushtëve sa më të mira për familjet rreth zonës së lumit, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrveshje.



Neni 3

Qëllimi i marrëveshjes

- 3.1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është sigurimi i zbatimit të projektit për lumin Toplluha në mënyrë korrekte, efikase dhe të përgjegjshme sipas fondeve lehtësuese të vëna në dispozicion për situatën e COVID-19 të financuara nga Qeveria Gjermane dhe sipas rregullave të GIZ dhe Komunes se Suharekës.
- 3.2. Komuna me qëllim zbatimin e projektit pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit sesioni Leshan – Tërrnje, mbrojtja nga vërshimet dhe krijimin e kushtëve sa më të mira për familjet rreth zonës së lumit, andaj pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshjeje.
- 3.3. GLV „Natyra” në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për zbatimin dhe ekzekutimin e projektit të bashkefinancuar GIZ, GLV Natyra dhe Komuna Suahrekë.

Neni 4

Obligimet e paleve

- 4.1. GLV „Natyra” është implementues i këtij projekti i cili parasheh rregullimin dhe resaturimin e shtratit të lumit si dhe do të udhëheq të gjitha procedurat e prokurimit dhe rekrutimit të punëtorve.
- 4.2. GLV „Natyra” është e obliguar të raportoj për përfundimin e projektit të lartpërmendur.
- 4.3. Raportimi duhet të bëhet me shkrim para institucioneve të Komunës së Suharekës (mbikqyresit të projektit).
- 4.4. Komuna e Suahrekës do të caktoj një mbikqyres nbi mbarëvajtjen e punimeve dhe realizimin e projektit të lartpërmendur.

Neni 5

Afati i Realizimit

Afati i realizimit të qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2021.

Neni 6

Obligimet financiare të Palëve

- 6.1. Vlera e gjithëmbarshme e projektit është **47,030.00 Euro**.
- 6.2. Komuna e Suharekës, do të participoj shumën prej 15,000.00 Euro dhe atë pas raportimit të mbikqyresit të projektit.
- 6.3. GLV „Natyra”, do të participoj shumën **32,030.00 Euro**.

Neni 7

Interpretimi dhe Ndryshimi

- 7.1. Interpretimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
- 7.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkuara nga ana e dy palëve.



Neni 8
Zgjidhja e Marrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

Neni 9
Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

PALËT NË MARRËVESHJE

GLV NATYRA
Grup Lokal i Veprimit

Ejup ISMAJLI
Kryetar i GLV Natyra
NATYRA
SHTIME


Komuna e Suharekës
Bali MUHARREMAJ
Kryetar i Komunës

08 shtator 2021
Komuna e Suharekës


REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E SUHAREKES